

**STATUTI**  
**i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve**

**Tekst i konsoliduar**

**Shkup, mars 2024**

Bazuar në nenin 158-s paragrafi 1, pika 5 e Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.27/02, 79/07, 88/08, 67/10, 44/11, 188/13, 43/14, 112/14, 153/15, 192/15, 23/16, 83/18 dhe 198/18) dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", numër 101/19, 31/20 dhe 173/22) neni 37, paragrafi (1) nga Statuti i Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve nr. 0201-238/2 me darë 24.09.2009 dhe Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve nr. 02-216/3 më 27.02.2015, nr.02-521/4 më 18.08.2015, nr.02-350/3 më 26.03.2019, nr.02-770/14 më 07.11.2019 dh nr. \_\_\_\_\_.2024 dhe Vendimin për ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të Agjencisë të Mbikëqyrjes së Sigurimeve numër 02-21/14 me datë 05.01.2018, Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë të Mbikëqyrjes të Sigurimeve në seancën e mbajtur më datë \_\_\_\_\_.2024 miratoi:

## **STATUTIN**

### **e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve**

#### **Tekst i konsoliduar**

## **I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1**

Me këtë statut determinohet struktura e përgjithshme, përcaktohet emri, selia, simboli, vula dhe stampa dhe rregullohet organizimi i brendshëm, menaxhimi dhe drejtimi, procedurat e miratimit të akteve, mënyra dhe kushtet për punësim, si dhe çështje të tjera të rëndësishme për punën e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (në tekstin në vijim: Agjencia).

### **Neni 2**

(1) Agjencia është organ rregullator i mëvetësishëm dhe i pavarur, me autorizime publike të përcaktuara me ligj.

(2) Agjencia kujdeset për funksionimin legjitim dhe efikas të tregut të sigurimeve me qëllim mbrojtjen e të drejtave të pronarëve dhe përdoruesve të sigurimeve.

(3) Agjencia ka cilsinë e personit juridik.

(4) Agjencia, për punën e saj i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

### **Neni 3**

(1) Agjencia kryen aktivitetet në vijim:

- kryen mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive për përfaqësimin e sigurimeve, brokerëve të sigurimeve, përfaqësuesve të sigurimeve dhe Byrosë Kombëtare të Sigurimeve.

- jep dhe revokon leje, pëlqime dhe liçenca në bazë të këtij ligji dhe të ligjeve që janë në kompetencë të saj;

- shqipton masa mbikëqyrëse në përputhje me ligjin;

- miraton akte nënligjore nga sfera e sigurimit;

- jep propozime për miratimin e ligjeve nga sfera e sigurimit në Ministrinë e Financave;

- kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e masave dhe veprimtarive të përcaktuara me Ligjin për parandalimin e larjes së parave dhe të ardhurave të tjera nga krimi dhe financimi i terrorizmit;

- është anëtare e Asociacionit Ndërkombëtar të Mbikëqyrësve të Sigurimeve edhe në

organet e Këshillit Evropian të Mbikëqyrësve të Sigurimeve dhe Organeve Mbikëqyrëse të Sigurimit Vullnetar Pensional;

- bashkëpunon me institucione të tjera kompetente të mbikëqyrjes së tregut financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- nxit zhvillimin e sigurimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- zhvillon vetëdijen publike për rolin e sigurimit dhe rolin e mbikëqyrjes së sigurimeve; dhe
- kryen veprimtari të tjera në përputhje me ligjin dhe këtë statut.

(2) Aktet nënligjore të miratuara nga Agjencia publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## **II. EMRI, SELIA, SIMBOLI, VULA DHE STAMPA**

### **Neni 4**

(1) Emri i Agjencisë është: "Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve".

(2) Emri i Agjencisë shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, në gjuhën që flasin të paktën 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj, si dhe në gjuhën angleze.

(3) Emri i Agjencisë shkruhet me madhësi dhe font të njëjtë. Emri në gjuhën maqedonase shkruhet i pari.

### **Neni 5**

Selia e Agjencisë është në Shkup, në bulevardin "Maqedoniai" nr.25"

### **Neni 6**

(1) Simboli i Agjencisë është stema.

(2) Stema simbolizon subjektin e veprimtarisë së Agjencisë, gjegjësisht kompetencat e Agjencisë. Varësisht nga forma e stemës, emri i Agjencisë është i shkruar rreth saj,

(3) Ilustrimi artistik-grafik i stemës dhe përdorimi i saj përcaktohet me vendim të posaçëm.

### **Neni 7**

(1) Agjencia ka vulën dhe stampën e saj.

(2) Vula e Agjencisë ka formë të rrumbullakët, me diametër prej 32 mm. Në anën e brendshme të vulës në formë të një gjysmërrethi shkruhet teksti në vijim "AGJENCIA E MBIKËQYRJES SË SIGURIMEVE", në mes të vulës qëndron "stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa nën stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, citohet selia e Agjencisë SHKUP. Teksti është shkruar në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj. Në buzë të vulës rrethore, janë tërhequr dy vija të holla paralele.

(3) Nëse Agjencia ka nevojë për më shumë kopje të vulës, ato janë identike në përmbajtje dhe madhësi dhe secila prej tyre është e shënuar me numër rendor të shkruar me numra romakë.

(4) Agjencia në veprimtarinë e saj përdor stampën.

(5) Agjencia do të projektojë stampa përkatëse për nevojat e veprimtarisë së saj duke marrë vendim për përpilimin e tyre, në të cilin do të shkruhet qëllimi, forma, madhësia dhe përmbajtja e saj.

(6) Teksti i stampës është shkruar në gjuhën maqedonase me alfabetin cirilik, në gjuhën që e flasin të paktën 20 për qind e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

(7) Me vendim të veçantë përcaktohet mënyra e përdorimit, ruajtjes dhe shfuqizimit të vulës dhe stampës.

### **III. ORGANIZIMI I BRENDSHËM**

#### **Neni 8**

Agjencia rregullohet në atë mënyrë që siguron, kryerjen e kompetencave dhe detyrimeve ligjore të përcaktuara me ligj në mënyrë profesionale, efikase dhe ekonomike, orientimin për shërbim ndaj personave fizikë dhe juridikë, pavarësinë dhe përgjegjësinë në kryerjen e obligimeve të punës, unifikimin e njësive organizative dhe përshtatshmërinë e tyre me kompetencat dhe obligimet e organit dhe me nevojat e personave fizikë dhe juridikë.

#### **Neni 9**

(1) Organ i Agjencisë është Këshilli i Ekspertëve.

(2) Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë përbëhet prej pesë anëtarëve, prej të cilëve njëri është kryetar.

(3) Kryetari i Këshillit të Ekspertëve menaxhon Agjencinë dhe përfaqëson atë në marrëdhëniet me palët e treta.

Në rast të mungesës ose joprezencës të Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve, me autorizim të Këshillit të Ekspertëve, Agjencinë e menaxhon dhe e përfaqëson në marrëdhënie me palë të treta njëri prej anëtarëve të angazhuar profesionalisht në Këshillin e Ekspertëve me orar të plotë pune në Agjenci.

(4) Kryetari dhe katër anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë i emëron dhe i shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Mandati i anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve është 5 vjet, me mundësi rizgjedhjeje.

(6) Pavarësisht nga pika e mëparshme e këtij neni në mandatin e parë të konstituimit të Këshillit të Ekspertëve, kryetari dhe një anëtar emërohen për pesë vjet, dy anëtarë emërohen për katër vjet dhe një anëtar emërohet për tre vjet. Cili anëtar do të emërohet për pesë, katër apo tre vjet, vendos Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të propozimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve mund të shkarkohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe para përfundimit të mandatit, vetëm në rast se përmbushet së paku një prej kushteve të parashikuara në nenin 12 të këtij Statuti.

(8) Në rastet kur ndonjëri nga anëtarët e Këshillit të Ekspertëve përfundon të kryejë detyrën e tij para skadimit të mandatit, në vend të tij caktohet një person tjetër me mandat deri në mbarimin e mandatit të anëtarit të cilit i është ndërprerë detyra.

(9) Kryetarin dhe të paktën dy anëtarë të Këshillit të cilët, në bazë të propozimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga paragrafi (4) i këtij neni i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët profesionalisht janë të angazhuar në Agjenci me orar të plotë dhe nuk mund të kenë funksion tjetër dhe të jenë të punësuar në një tjetër vend pune, apo të marrin kompensim tjetër përveç pagës dhe shtesave të tjera në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet e punës dhe me marrëveshjen kolektive, si dhe kompensime nga honoraret e herëpashershëm edukative dhe autoriale.

#### **Neni 10**

(1) Anëtar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë mund të zgjidhet personi i cili plotëson kushtet në vijim:

- 1) të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) të ketë përfunduar arsimin universitar
- 3) të jetë ekspert i njohur në fushën e sigurimeve, financave ose të drejtën tregtare dhe të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në fushën e sigurimeve apo financave;

(2) Anëtar i Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë nuk mund të emërohet personi:

- 1) të cilit i është shqiptuar dënim me burg për vepra penale kundër financave publike, kundër operacioneve të pagesave dhe ekonomisë, kundër detyrës zyrtare apo kundër qarkullimit ligjor;
- 2) të cilit i është shqiptuar ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- 3) i cili është zyrtar që administron ndonjë organ shtetëror apo ndonjë organ të administratës shtetërore;
- 4) i cili është anëtar i një organi menaxhues, një autoriteti mbikëqyrës apo person i punësuar në një kompani të sigurimeve, shoqëri të brokerimit të sigurimit apo person tjetër juridik mbi të cilin Agjencia kryen mbikëqyrje;
- 5) i cili është aksionar në një shoqëri sigurimi, shoqëri të brokerimit të sigurimit, shoqëri avokimi të sigurimit apo ndonjë person tjetër juridik mbi të cilin Agjencia kryen mbikëqyrje;
- 6) i cili është anëtar i organeve të një partie politike;
- 7) i cili është deputet apo person që kryen detyrë tjetër në të cilën është i emëruar nga Qeveria apo Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut;

(3) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Ekspertëve janë të obliguar të kryejnë punën e tyre në mënyrë profesionale dhe në mënyrë që të mos sjellin në dyshim pavarësinë dhe autonominë e Agjencisë.

(4) Ndalohet çdo formë e ndikimit në punën e Këshillit të Ekspertëve që mund të ndikojë në pavarësinë dhe autonominë e Agjencisë.

(5) Punonjësit e Agjencisë nuk mund të jenë anëtarë të Shoqërive të sigurimeve apo persona të tjerë juridikë mbi të cilët Agjencia kryen mbikëqyrje dhe nuk mund të kryejnë detyra individuale për ata persona juridikë.

## **Neni 11**

- (1) Gjatë kryerjes së obligimeve të tij, kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të cilët profesionalisht janë të angazhuar në Agjenci me orar të plotë dhe punonjësit e Agjencisë kanë të drejtë page, shtesë të pagës dhe kompensime të tjera në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune dhe marrëveshjen kolektive.
- (2) Të punësuarit në Agjenci të cilët kryejnë punë administrative, kanë statutin e nëpunësve administrativë. Mënyra e konfirmimit të pagës bazë dhe shtesave të pagës për të punësuarit në Agjenci rregullohet sipas marrëveshjes kolektive.
- (3) Të punësuarit në Agjenci të cilët kryejnë aktivitete ndihmës-teknike, kanë statusin e personelit ndihmës-teknik. Mënyra e konfirmimit të pagës bazë dhe shtesave të pagës për personelin ndihmës-teknik në Agjenci rregullohet sipas rregullave të përgjithshme të marrëdhënieve të punës dhe akteve të tjera në Agjenci.
- (4) Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të cilët nuk janë profesionalisht të angazhuar në Agjenci kanë të drejtë të një kompensimi mujor nga fondet e Agjencisë, në masën prej 33,3%

(tridhjetë e tre, presje tre për qind) të pagës neto të kryetarit të Këshillit të Ekspertëve pa përvojë pune.

- (5) Fondet për paga, shtesat e rrogave, kompenzimet mujore dhe kompensimet e tjera të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ekspertëve dhe punonjësve të Agjencisë sigurohen nga mjetet e Agjencisë të përcaktuara me planin financiar vjetor.
- (6) Kryetari, anëtarët e Këshillit të Ekspertëve dhe të punësuarit në Agjenci kanë të drejtën të zhvillojnë aktivitete profesionale dhe shkencore dhe të marrin pjesë në veprimtaritë e shoqatave profesionale apo shkencore.
- (7) Kryetari, anëtarët e Këshillit të Ekspertëve dhe punonjësit e Agjencisë gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tyre gjegjësisht të marrëdhënies së punës nuk duhet të marrin asnjë kompensim, apo pagesë, të pranojnë funksion, apo punësim, apo të ofrojnë çfarëdo lloj shërbimi për subjektet mbi të cilët zbatojnë mbikëqyrje si dhe personat që janë të lidhur me to në pajtim me Ligjin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve.

#### **Neni 12**

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar, mund të shkarkojë anëtarin e këshillit të ekspertëve ose kryetarin e Këshillit nëse:

- 1) ai vetë e kërkon atë;
- 2) e humb aftësinë e punës;
- 3) e shkel detyrimin e mbrojtjes së të dhënave konfidenciale nga neni 27 i këtij Statuti;
- 4) mungon në mënyrë të pajustificueshme në tri seanca të Këshillit në mënyrë të njëpasnjëshme apo mungon në mënyrë të pajustificueshme në 5 seanca gjithsej gjatë një viti;
- 5) nëse nuk i plotëson më kushtet e paragrafit (2) dhe (3) të nenit 10 të këtij Statuti.

#### **Neni 13**

Këshilli i Ekspertëve, përveç kompetencave të përcaktuara me ligj, ka edhe kompetencat në vijim:

- miraton rregulloren e punës për seancat;
- miraton rregullore me të cilën përcaktohet fushëveprimi i punës së njësive organizative;
- miraton rregullore për sistematizimin e vendeve të punës;
- rregullore për pagat;
- rregullore për përgjegjësinë disiplinore të punonjësve;
- vendos për të drejtat e punonjësve në shkallën e dytë;
- miraton kod të etikës për punonjësit;
- krijon komisione për çështje më komplekse në fushëveprimin e punës së Agjencisë;
- miraton plan vjetor të furnizimeve publike;
- miraton rregullore për sekret afarist; dhe
- miraton akte të tjera të përgjithshme që rregullojnë punën e Agjencisë.

### **IV. PROCEDURA E MIRATIMIT TË AKTEVE**

#### **Neni 14**

- (1) Këshilli i Ekspertëve punon dhe vendos në seanca.

(2) Këshilli i Ekspertëve mbledhet të paktën dy herë në muaj.

(3) Këshilli i Ekspertëve mund të marrë vendime në kuadër të jurisdiksionit të tij, nëse në seancë janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.

(4) Vendimet e Këshillit të Ekspertëve janë të miratuara nëse për të njëjtat kanë votuar shumica e anëtarëve të pranishëm në seancë, ndërsa kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Ekspertëve nuk mund të abstenojnë nga votimi.

(5) Në rast të mungesës apo mosprezencës të kryetarit të Këshillit të Ekspertëve, kryetarin gjatë mungesës apo mosprezencës së tij e zëvendëson anëtari ekzekutiv i këshillit i cili emërohet me mandat si edhe kryetari i Këshillit të Ekspertëve.

#### **Neni 15**

(1) Kryetari i Këshillit të Ekspertëve ka këto kompetenca:

- organizon dhe siguron kryerjen ligjore të veprimtarive të fushëveprimit të Agjencisë;
- menaxhon njësitë organizative profesionale në Agjenci;
- publikon shpallje për punë, kryen përzgjedhje, nënshkruan kontrata për punësim dhe kryen shpërndarjen e punonjësve në pajtim me aktin për sistematizimin e vendeve të punës;
- organizon dhe menaxhon punën e Agjencisë, kujdeset për zhvillimin profesional të punonjësve në Agjenci;
- lëshon autorizime dhe urdhëra për punonjësit për kryerjen e mbikëqyrjes, si dhe autorizime për kryerjen e veprimtarive që nuk bëjnë pjesë në fushëveprimin e mbikëqyrjes, për të cilat është kompetent me ligj edhe me këtë statut;
- dërgon punonjësit në udhëtime zyrtare, që të marrin pjesë në seminare, konferenca, trajnime dhe formim profesional në vend dhe jashtë vendit;
- vendos për të drejtat që burojnë nga marëdhënia e punës (pagat, pushimet vjetore, pushimet e paguara dhe të papaguara, etj)
- lidh kontrata për dhënie me qira të hapësirave banesore dhe afariste;
- miraton të gjitha llojet e vendimeve nga sfera e furnizimeve publike dhe lidh kontrata për furnizime publike;
- vendos dhe ruan bashkëpunimin me organe mbikëqyrëse dhe organizata të sferës së sigurimit, si dhe me organe mbikëqyrëse dhe organizata të sferës së institucioneve financiare dhe jofinanciare;
- kryen kompetenca të tjera për të cilat është i autorizuar me ligj, me këtë Statut dhe me aktet e veçanta të Këshillit të Ekspertëve.

#### **Neni 16**

(1) Me njësitë organizative profesionale në Agjenci, përveç Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve menaxhojnë edhe anëtarët e angazhuar profesionalisht, në Agjenci me orar të plotë, të Këshillit të Ekspertëve.

(2) Vendimin për sferat të cilat do t'i udhëheqin dhe kompetencat e anëtarëve të angazhuar profesionalisht të Këshillit të Ekspertëve në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni e miraton Kryetari i Këshillit të Ekspertëve.

#### **Neni 17**

Për kryerjen e punëve të rregullta në Agjenci, formohen njësi organizative profesionale si: sektore profesionale, drejtori dhe drejtori të pavarura.

### **Neni 18**

Rregullorja për organizimin e brendshëm të Agjencisë përshkruan në mënyrë të detajuar fushëveprimin e punës së njësive organizative të përcaktuara me nenin 17 të këtij Statuti.

## **V. MËNYRA DHE KUSHTET E PUNËSIMIT DHE SHPËRNDARJES SË PUNONJËSVE NË AGJENCI**

### **Neni 19**

Procedura për punësimin dhe shpërndarjen e punonjësve në Agjenci kryhet në pajtim me Ligjin për Nëpunës Administrativë, marrëveshjen kolektive, Ligjin për Marrëdhënie Pune, me këtë Statut, me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci dhe aktet e tjera të miratuara nga Këshilli i Ekspertëve që rregullojnë të drejtat nga marrëdhënia e punës.

### **Neni 20**

(1) Kundër vendimit të kryetarit të Këshillit të Ekspertëve me të cilin vendoset për përzgjedhjen e kandidatit për punësim për të cilin zbatohen rregulloret e përgjithsme për marrëdhëniet e punës, si dhe për vendimet për të drejtat e punonjësve nga marrëdhënia e punës, mund të paraqitet ankimim në Këshillin e Ekspertëve, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

(2) Këshilli i Ekspertëve vendos për ankimimin nga paragrafi 1 i këtij neni në një afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së ankimit.

(3) Vendimi i Këshillit është i formës së prerë.

(4) Nëse Këshilli i Ekspertëve nuk ka miratuar vendim, apo vendimi është negativ kandidati për punësim, apo punonjësi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore në afate kohore dhe procedura në pajtim me Ligjin për Marrëdhënie Pune.

Во член 20 став (1) по зборовите „вработување“ се додаваат зборовите „за кој се применуваат општите прописи за работните односи,“.

### **Neni 21**

(1) Anëtarët e angazhuar profesionalisht të Këshillit të Ekspertëve, pas skadimit të mandatit për të cilin ata janë emëruar kanë të drejtë aplikimi për punësim dhe të punësohen në Agjenci.

(2) Kërkesa për punësim nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të dorëzohet 30 ditë para mbarimit të mandatit.

(3) Anëtarët e angazhuar profesionalisht të Këshillit të Ekspertëve, të cilët do të shfrytëzojnë të drejtën nga paragrafi 1 i këtij neni do të caktohen në vende pune në pajtim me Ligjin për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci.

## **VI. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E PUNONJËSVE**

### **Neni 22**

Punonjësit e Agjencisë, të drejtat dhe obligimet e tyre i realizojnë në pajtim me Ligjin për Nëpunës Administrativë, marrëveshjen kolektive, Ligjin për Marrëdhënie Pune, Statutin e Agjencisë dhe aktet e tjera të përgjithshme të Agjencisë.

### **Neni 23**

(1) Punonjësit e Agjencisë janë të obliguar të kryejnë punën me ndërgjegjshmëri, profesionalitet, me rregull dhe në kohë, në pajtim me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në Agjenci.

(2) Punonjësit janë të obliguar të kryejnë punën në mënyrë të paanshme, pa ndikim nga interesi

personal financiar, të mos abuzojnë me autorizimet e fituara dhe të mbrojnë reputacionin dhe interesat e Agjencisë.

(3) Puna e punonjësve në Agjenci bazohet në parimet e profesionalizmit, transparencës dhe përgjegjshmërisë për punën dhe rezultatet e arritura.

## **VII. MËNYRA E TË PUNUARIT**

### **Neni 24**

Puna e Agjencisë është publike.

### **Neni 25**

(1) Vendimet dhe aktet e tjera, si dhe të dhënat që janë në dispozicion të opinionit në pajtim me Ligjin, Agjencia i publikon në faqen e saj të internetit, në bordin e buletinit të Agjencisë, në media ose në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

(2) Kopje të dokumenteve që janë të aksesueshme për opinionin për të cilat Agjencia mban shënime në bazën e të dhënave në pajtim me Ligjin, mund të merren duke paguar shpenzimet aktuale të cilat Këshilli i përcakton me vendim.

### **Neni 26**

Agjencia bashkëpunon me përfaqësuesit e organizatave të konsumatorëve të shërbimeve të komunikimit elektronik, duke organizuar takime publike për të cilat do të informohen me kohë dhe të cilëve do t'u jepet mundësia e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe opinioneve dhe forma të tjera të bashkëpunimit.

## **VIII. MBROJTJA E TË DHËNAVE KONFIDENCIALE – SEKRETI AFARIST**

### **Neni 27**

(1) Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve dhe punonjësit e Agjencisë janë të obliguar t'i ruajnë si konfidenciale të dhënat në lidhje me subjektet mbi të cilët Agjencia kryen mbikëqyrje dhe të dhëna të tjera që lidhen me faktet dhe rrethanat të cilat i kanë mësuar gjatë zbatimit të punës së tyre, me përjashtim të të dhënave të cilat, sipas dispozitave të Ligjit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve, janë publike. Obligimi për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale ekziston edhe pas përfundimit të funksionit të tyre apo të punësimit të tyre.

(2) Të dhënat e marra gjatë punës në Agjenci mund të zbulohen vetëm për:

- 1) punonjësit e Agjencisë dhe Anëtarët e Këshillit të Ekspertëve në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre zyrtare;
- 2) organet e tjera kompetente për mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me kusht që Memorandumi i mirëkuptimit të lejojë zbulimin e të dhënave të tilla;
- 3) autoritetet dhe institucionet e zbatimit të ligjit;
- 4) gjykatën kompetente;
- 5) mbikëqyrësit e sigurimeve të vendeve të tjera në pajtim me memorandumet e mirëkuptimit apo marrëveshjet ndërkombëtare.

(3) Për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale të punës me persona jashtë vendit zbatohen masa të veçanta.

(4) Punonjësit që punojnë me dokumente dhe të dhëna të cilat janë të deklaruara si konfidenciale

janë të obliguar:

- t'i ruajnë në një vend të sigurtë;
- të mos bëjnë ndonjë deklaratë në lidhje me to; dhe
- të mos i japin për hetim ose përdorim, pa autorizim të posaçëm.

#### **Neni 28**

(1) Shkelja e obligimit të ruajtjes së sekretit afarist paraqet shkelje të obligimit të punës.

(2) Nuk konsiderohet shkelje e ruajtjes së sekretit të punës nëse të dhënat dhe dokumentet që konsiderohen si sekrete të punës komunikohen, gjegjësisht iu jepen për hetim të personave, apo organeve të cilët të njëjtat mund, apo duhet t'i komunikohen në bazë të ndonjë norme, apo një autorizimi të dhënë nga personi i autorizuar.

(3) Punonjësi i cili bën komunikime sipas paragrafit 2 të këtij neni është i obliguar t'i paralajmërojë të pranishmit se bëhet fjalë për sekret afarist.

### **IX. FINANCIMI I AGJENCISË**

#### **Neni 29**

(1) Veprimtaria e Agjencisë në pajtim me këtë ligj, financohet nga kompensimet të cilat Agjencia i mbledh nga shoqëritë e sigurimeve, shoqëritë e brokerimit në sigurime, shoqëritë e ndërmjetësimit të sigurimit dhe persona të tjerë mbi të cilët Agjencia kryen mbikëqyrje, duke i përfshirë edhe këto në vijim:

- (1) Kompensim vjetor për zbatimin e mbikëqyrjes së shoqërive të sigurimeve, shoqërive të brokerimit në sigurime, shoqërive të ndërmjetësimit në sigurime në vlerë deri më 0,08% të primit të përgjithshëm vjetor bruto të shoqërive të sigurimit gjegjësisht të të ardhurave të përgjithshme vjetore nga komisionet e shoqërive të brokerimit të sigurimeve, shoqërive të ndërmjetësimit të sigurimeve;
- (2) Kompensime për dhënien e lejeve për kryerjen e veprimtarisë së sigurimeve dhe leje të tjera nga neni 31 i Ligjit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve;
- (3) Kompensime për dhënien e lejeve për kryerjen e veprimtarisë së brokerimit në sigurime dhe veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime;
- (4) Kompensime për dhënien e licencave të brokerit të sigurimit dhe ndërmjetësit të sigurimit;
- (5) Kompensime për dhënien e lejeve për kryerjen e veprimtarisë së aktuarit të autorizuar;
- (6) Kompensime për dhënien e pëlqimeve nga neni 66 i Ligjit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve;
- (7) Kompensime për masat e shqiptuara të mbikëqyrjes;
- (8) Donacione, hua dhe ndihmë tjetër financiare dhe teknike.

(2) Agjencia miraton Listë të Tarifave me të cilën përcaktohen përmbajtja dhe vlera e kompensimeve dhe pagesave të tjera nga paragrafi (1) i këtij neni. Lista e Tarifave publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### **Neni 30**

(1) Fondet e Agjencisë mbahen në llogari tek një bartës i qarkullimit pagesor në Republikën e Maqedonisë.

(2) Agjencia mund të ketë më shumë se një llogari në denarë apo monedhë të huaj, në pajtim me Ligjin e qarkullimit pagesor.

### **Neni 31**

- (1) Agjencia mban regjistra të biznesit në pajtim me rregullat e kontabilitetit të organizatave jofitimprurëse në Republikën e Maqedonisë.
- (2) Për mbajtjen e rregullt dhe të azhurnuar të regjistrave të biznesit është përgjegjës Kryetari i Këshillit të Ekspertëve dhe anëtar i angazhuar profesionalisht i Këshillit të Ekspertëve i cili mbulon njësinë organizative në të cilën mbahen regjistrat e biznesit të Agjencisë.

## **IX. I. Fondi rezervë i Agjencisë**

### **Neni 32**

Nëse gjatë vitit të kaluar të biznesit Agjencia realizon tepricë të të ardhurave mbi kostot e realizuara, teprica e realizuar e fondeve shpërndahet në fondin rezervë të Agjencisë.

## **IX. II. Mbulimi i humbjes**

### **Neni 33**

Nëse gjatë vitit të kaluar afarist Agjencia kryen më shumë kosto në raport me të ardhurat e realizuara, mungesa e fondeve kompensohet nga Fondi rezervë i Agjencisë.

## **IX. III. Pasqyrat financiare dhe plani financiar i Agjencisë**

### **Neni 34**

- (1) Këshilli i Ekspertëve është i detyruar brenda 30 qershorit të vitit aktual t'i dorëzojë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut pasqyra financiare për vitin e kaluar të përgatitura në pajtim me standardet ndërkombëtare të raportimeve financiare dhe të audituara nga auditori i autorizuar.
- (2) Këshilli i Ekspertëve është i detyruar brenda 31 dhjetorit të vitit aktual t'i dorëzojë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut plan financiar për vitin e ardhshëm.
- (3) "Deri në miratimin e planit financiar për vitin pasardhës nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, funksionimi i Agjencisë do të financohet përkohësisht në kuadër të të ardhurave dhe shpenzimeve të planifikuara në planin financiar për vitin pasardhës të miratuar nga Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë."
- (4) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së veriut miraton pasqyrat financiare të vitit të kaluar dhe planin financiar.

## **IX. IV. Pasqyra e gjendjes në tregun e sigurimeve**

### **Neni 35**

- (1) Agjencia përgatit Pasqyrë vjetore për gjendjen dhe lëvizjet në tregun e sigurimeve dhe ia dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim.
- (2) Pasqyra nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të përmbajë të dhëna për volumin e veprimtarive të kryera të sigurimit sipas klasave të sigurimit.

(3) Agjencia është e obliguar t'ia dorëzojë pasqyrën nga paragrafi (1) i këtij neni Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda 30 qershorit të vitit aktual për vitin e kaluar të biznesit.

(4) Në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Pasqyrës nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia e publikon atë në web faqen e saj.

#### **IX. V. Pasqyra vjetore**

##### **Neni 36**

1) Agjencia përgatit pasqyrë vjetore për veprimtarinë e saj dhe ia dorëzon Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim.

2) Pasqyra nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të përmbajë të dhëna për masat e shqiptuara të mbikëqyrjes që i ndërmerr Agjencia në pajtim me procedurat e kryera të mbikëqyrjes, lejet e dhëna dhe të revokuara të kryerjes së veprimtarisë së sigurimeve dhe lejet dhe pëlqimet e tjera të lëshuara nga Agjencia, si dhe të dhëna për bashkëpunimin e Agjencisë me organe vendore dhe të huaja të mbikëqyrjes.

3) Agjencia është e obliguar t'ia dorëzojë pasqyrën nga paragrafi (1) i këtij neni Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut brenda 30 qershorit të vitit aktual për vitin e kaluar.

4) Në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të Pasqyrës nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia e publikon atë në web faqen e saj.

#### **X. NDRYSHIMI I STATUTIT DHE AKTEVE TË TJERA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 37**

(1) Ky statut ndryshohet me vendim për ndryshimin e statutit në procedurë të njëjtë si për miratimin e statutit.

(2) Propozim për ndryshimin e statutit të Agjencisë mund të propozojë çdo anëtar i Këshillit të Ekspertëve. Propozim ndryshimi i statutit duhet të jetë i arsyetuar.

(3) Iniciativë për ndryshimin e statutit mund të dorëzojë çdo punonjës i Agjencisë. Iniciativa e ndryshimit të statutit me arsyetimin e duhur i dorëzohet Kryetarit të Këshillit të Ekspertëve.

##### **Neni 38**

(1) Çështje të tjera që janë të rëndësishme për Agjencinë, por që nuk janë të rregulluara me këtë statut, mund të rregullohen, në pajtim me ligjin dhe këtë statut me akte të tjera të Këshillit të Ekspertëve, siç janë rregulloret, rregullorja e procedurave ose rregullorja e punës, vendime etj.

#### **XI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 39**

(1) Agjencia regjistrohet në regjistrin e personave të tjerë juridikë i cili mbahet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Aplikimin e regjistrimit në Regjistrin qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut e dorëzon Kryetari i Këshillit të Ekspertëve.

**Neni 40**

Ky statut hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e miratimit të tij.

**KËSHILLI I EKSPERTËVE**

**KRYETARI**

---